



VENDIM

Nr. 166, Datë 10.10.2016

**PER MIRATIMIN E “RREGULLORE PËR LIDHJET E REJA NË
SISTEMIN E SHPËRNDARJES”**

Ne mbeshetje te nenit nenit 16, neni 20, gërmat “a”; nenit 27, pika 3; nenit 108, pika 3; nenit 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhenenit 26 të “Rregullores mbi Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, date 17.06.2016,të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.10.2016, pasi shqyrtoi relacionin per miratimin e “Rregullores per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shperndarjes”, të përgatitur nga Drejtorite Teknike;

Konstatoi se:

1. Me Vendimin Nr. 60, date 29.04.2016, Bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e draft-“Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes.”
2. Me shkresen Nr.350 Prot, date 03.05.2016, “Lidhur me draftet e akteve nenligjore ne proces miratimi nga ERE”, Enti Rregullator i Energjise i ka derguar per mendim, paleve te interesuara draftin e “Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes.”
3. Me shkresen Nr. 350/4, date 26.05.2016 te MZHETTS eshte shpehur parimisht dakort dhe ka paraqitur disa komente perkatese lidhur me draft “Rregulloren per lidhjet e Reja me sistemin e Shperndarjes”, te cilat jane reflektuan ne Rregullore.
4. Me shkresen me Nr. 350/1, date 20.05.2016 Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial, prane MEI-it, ka shprehur dakordesine e tij lidhur me Draft Rregulloren, duke parashtruar dhe disa komente perkatese,te cilat u reflektuan ne Rregullore.

5. Ne shkresen me Nr. 350/2, date 23.05.2016, Ministria e Energjise dhe Industrise eshte shprehur parimisht dakord me draft "Rregulloren per Lidhjet e Reja me Sistemin e Shperndarjes", duke mos shtuar asnje koment.
6. Me shkresen Nr. 350/8 Prot, date 26.07.2016, ERE i ka derguar paleve te interesuara nje draft te permiresuar te "Rregullores per lidhjet e reja ne sistemin e shperndarjes se energjise elektrike", i propozuar nga shoqeria "OSHEE" sh.a.
7. Ne shkresen me Nr.281/1 Prot, date 08.08.2016, Autoriteti I Konkurences, ka shprehur qendrimin e tij, i cili eshte reflektuar ne rregullore.
8. Ne shkresen me Nr.228/1 Prot, date 29.07.2016, Avokati i Popullit, ka shprehur qendrimin e tij lidhur me rregulloren, I cili eshte reflektuar ne Rregullore.
9. Me shkresen Nr.6101 Prot, date 03.08.2016, MZHETTS eshte shprehur parimisht dakord me rregulloren.
10. Me shkresen Nr.7425/1 Prot, date 05.08.2016, Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ka shprehur qendrimin e tij, i cili eshte reflektuar ne rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratoje "Rregulloren per Lidhjet e Reja me Sistemin e Shperndarjes", se bashku me anekset perkatese (Tarifat per Lidhjet e Reja dhe Marreveshja e Lidhjes se Re"
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorëve të njoftojë palet e interesuara per Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.